

VENDIM
Nr. 258, datë 27.3.2013

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT
TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “VËLLEZËRIT TOLA”, SHPK, “ARTI” SHPK, DHE “GPA
KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT
GOSTIMË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4 e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vëllezërit Tola” sh.p.k., “Arti” sh.p.k., dhe “GPA Konstruktion”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Gostimë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha